



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Construmax ShPK" të datës 04.11.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 28.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "76 Ndërtimi i qendrës për punës sociale" me nr. të prokurimit 616-24-9810-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Construmax ShPK" të datës 04.11.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 28.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "76 Ndërtimi i qendrës për punës sociale" me nr. të prokurimit 616-24-9810-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Construmax ShPK" (tutje "parashtruesi") me datë 04.11.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 28.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "76 Ndërtimi i qendrës për punës sociale" me nr. të prokurimit 616-24-9810-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

- Ka ndërhyr në formularin standarte të DT përkatësisht në Aneksin 7.1 duke shtuar tekst kushtëzues për AK, i cili nuk ka qenë në formularin standartë të DT.
- Ka plotësuar gabimisht disa pozicione të përqindjeve dhe nuk janë vërejt nga komisioni
- Lideri nuk ka plotësuar 60% e kërkuar të punëtorëve të trijanuar, që ka qenë kërkesë 13 e DT.
- As lideri e as grupi nuk kanë arritë të dëshmojnë që kanë përmbushur referenca për kryerjen e punimeve mbrenda 3 vite në vlerë prej 3.5 milion euro.
- Kan vazhduar validitetin e certifikatës një tekniki në mënyrë retrokative.
- Vlerisimin e rrishtit e ka të pjesërisht, dmth nuk ka të prezentuar për të gjitha vendet e punës të prezentuar në ofertë. Dmth vlersësimi i rrishtit të këtij GOE nuk është i plotë dhe jo në përputhje me Ligjin 04 L-161 siç ka qenë kërkesa e 15 e DT.
- Marrveshjen për mebturina nuk ka validitet deri në përfundim të këtij projekti dhe është i përcaktuar për peridhu fikse deri me 10.04.2025 ndërsa planifimi i kryerjes së punimeve nga ky GOE është në qershor 2025.
- Iso Standartet nuk kanë të prezentuar vazhdimin e tyre, të cilat janë detyruese edhe në bazë edhe të vetë të certifikatave.
- I mungojnë deklaratat në a, b, c për krijimin e grupit (marrveshjen e konzerciumit), ose nuk na është prezentuar në qasje.
- I mungon plani dinamik ose nuk e ka të prezentuar për të gjitha pozicionet sipas formularit, dhe nuk na është ofruar në qasje.
- Nuk ka të dorëzuar Deklaratat e ATK-së për 3 vitet e fundit ose nuk është prezentuar në qasje.
- Ka të prezentuar kontrata për staf që përshkrimi mbrenda kontratës dallon me vetë emërtimin e kontratës, po ashtu ka prezentuar kontratë të pa caktuar dmth nuk dihet për qka është fjala dhe këto kontrata nuk janë në bazë të ligjit të punës.
- Nje format te kontratës e ka nje vite para se te publikoj formen standarte nga MPMS.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye si në vijim:

ARSYETIM

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar: GOE Construmax Sh.P.K. dhe Harst Group SH.P.K. kanë prezentuar referenca bankare për kapitalin financiar sipas Kriterit 2 në FDT, ku është kërkuar
2. Kapital financiar të njaftueshëm për realizimin e kontratës në vlerë 600,000.00 euro duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin në fjalë ose qasje në kredi të pa kushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia. 60% Lideri. Me ç'rast, Construmax SHPK ka prezentuar leter reference nga Pro Credit Bank në vlerën prej 500,000.00 €. Ndërsa Harst Group SH.P.K. ka prezentuar dy referenca nga bankat: TEB SHA dhe BKT (Banka Kombetare Tregtare), dhe sipas këtyre referencave të prezentuara nga HARST GROUP SH.P.K. kjo kompani nuk ka kapital financiar apo qasje në kredi të pakushtëzuar në vlerën 100,000.00 €. Si rrjedhojë, GOE nuk e plotëson kriterin për kapital financiar të njaftueshëm në vlerën 600,000.00 €
2. Tek kriteri nr. 5. Inxhinier i diplomuar i makinerisë (min. 3 vjet provojë pune pas diplomimit), të jetë i certifikuar nga një institucion shtetëror ose ndërmarrje publike për ndihmën e parë. GOE nuk ka prezentuar një inxhinier të makinerisë I certifikuar nga ndonjë institucion shtetëror ose ndërmarrje publike për ndihmën e parë, ka prezentuar z. Remzi Selimi si inxhinier I makinerisë por pa certifikimet e kërkuara.
3. Tek kriteri nr. 6. Një inxhinier i makinerisë drejtimi termocnergjetikë, i certifikuar për auditimin e energjisë efçente. Së paku 5 vite provojë pune pas diplomimit. Nuk është prezentuar CV e nënshkruar, i mungon përvoja e kërkuar në FDT si dhe i mungojnë referencat.
4. Tek kriteri nr. 8. Bachelor i arteve në menaxhimin e emergjencave - (min. 3 vjet provojë pune pas diplomimit). Ka prezentuar një Master të Emergjencave dhe jo Bachelor sipas kërkesës së

Page 2 nga 16

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

dosjes së tenderit. Poashtu, nuk ka prezantuar ndonjë licencë apo certifikatë për punë ndërtimore nga ndonjë institucion shtetëror.

5. Tek kriteri nr. 10. Një master shkencave teknike, drejtimi gjeoteknikë. Nostrifikim i diplomës e dëshmon kualifikimin për inxhinier ndërtimi dhe jo master i shkencave teknike, drejtimi gjeoteknikë.

6. Certifikatat e stafit për SSHP (siguri dhe shendet ne pune) ku sipas kerkeses se deshmise dokumentare kerkohet: 13. Lista e punëtove me të dhënat dhe pozitën sipas certifikatave të trajnimit me kontrata, ne rast se angazhohen vetëm për këtë projekt atëherë kontrata të jetë në mes dy palëve tek noteri me titull te ketij projekti. Trajnimi për siguri në punë sipas pozitës së punës. Në certifikatat e prezantuara, trajnimi për siguri dhe shendet në punë, nuk është bërë për pozitën që kanë të punësuarit që është mandatore sipas Ligjit të Punës dhe është kërkuar edhe në dosjen e tenderit. P.sh. i punësuar si Armirues, është trajnuar për siguri dhe shendet ne pune si punetor dhe jo si armirues siç është prezantuar, e njëjta vlenë edhe për latuesit, moleret, zdrukthetaret dhe suvatuesit.

7. Tek kriteri nr 14. Marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave e nënshkruar nga të dy palët – hudhjen e materialeve të demoluara (inerte). Deshmia dokumentare sipas FDT:

14. Marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave e nënshkruar nga të dy palët (original). Marrëveshja duhet të jetë para datës së njoftimit (Lideri). Lideri i konzorciumit nuk ka prezantuar marrëveshje valide me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave për hudhjen e materialeve të demoluara. Ka praqitur një marrëveshje me një kompani e cila nuk ka një deponi për hudhjen e mbeturinave por është licencuar vetëm për sa vijon: Mbledhje dhe bartje e mbeturinave komunale me nr. te grupit-kodit 20 te KSHM (Shtepiake dhe ato te ngjashme Komerciale, Industriale dhe institucionale) përfshirë edhe fraksionet e mbledhura ndaras.

8. Tek kriteri nr 16. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit; Aneksin 8 te DT. GOE ka prezantuar një listë dhe dokumentat tjera, me ç'rast në mospërputhje me listën i mungojnë:

9. ----1.12.1 Kamion kiper me kran me peshë bartëse maksimum 2 ton 2 ---- GOE nuk ka paraqitur dy kamionë me këtë kërkesë të dosjes.

10. ----1.14 Kamionetë dubel kabinë me vinç, peshë ngarkuese maksimale 800 kg 1 --- GOE ka paraqitur vetëm një kamionetë me 3 ulëse dhe nuk është prezantuar kapaciteti i peshës ngarkuese, ndërkohë Kamionetë Double kabinë është me 5 e më shumë ulëse. P.Sh. kamionetat tjera dabel kabinë i ka prezantuar si duhet me 7 ulëse.

11. ----1.22 Kallëpe betoni – dërrasë 500 m2 ---- në DUD të prezantuar i mungon pronësia.

12. ----1.25 Kontejner WC 1, dokumenti i pronësisë dhe kuptimit të përshkrimit i paqartë;

13. ----1.29 Rul hekur hekur me gjemba për ngjeshjen e dheut – peshë maksimale 1.5 ton 2 --- Mungon një rul Hekur hekur me gjemba dhe mungon dëshmia e pagesës. Poashtu, te asnjë rul nuk ka dëshmi se janë hekur hekur me gjemba dhe nuk dëshmohet pesha sipas kërkeses se kriterit. marrveshja eshte ne mes shitesit RUB Sh.P.K ndersa Blersi Rexha SH.P.K ku i mungon fletpagesa .

14. ----1.30 Një Kamion kiper me kran me pesh bartese 3-4ton Mungon.

15. ---- 1.31 Eskavator me pesh max 900kg eshte paraqitur nje DUD ku dyshohet se ka nderhyrje vetem te pesha, ku sipas Tipit te ekskavatorit ne specifikacion, pas hulumtimit në internet për tipin e paraqitur në dosjen e tenderit me të dhënat e paraqitura, pesha minimale e këtij tipi të ekskavatori është mbi kërkesën e dosjes dhe jo maksimumi 900kg sipas kërkesës së dosjes. Poashtu, në DUD-in e prezantuar në dosje, ka paqartësi tek pesha sipas DUD dhe krijohet

përshtypje se është ndërhyrë. Më poshtë fragment nga DUD-i i prezantuar në dosjen e tenderit ku vërehet dyshimi për ndërhyrje:

16. ---- 1.37 Traktori 4x4 me Lugë Ngarkuese -Mungon,kerkesa ka qen -. Certifikata e regjistrimit librezja e vlefshme e qarkullimit [Zbatohet për mekanizimin, automjetin ose mjetin ndërtimor i cili sipas ligjit i nënshtrohet procesit te regjistrimit],Traktorët i nënshtrohen procesit të regjistrimit.

17. ----1.6 Skele levizese 200m2-Mungojn.

18. ----1.7 Pomp Suvatimi -Mungon një njësi,por edhe njera qe eshte paraqitur mungon pronsia.

19. ----1.10 Skelet per pun ndertimore min 50002-Mungojn,por ka paraqitura skele te hekurit me kg ku ne asnji menyrr nuk i mbriijn ato metra katror edhe askund nuk ka deshmi qe jan 5000m2.

20. ----Nuk është plotësuar Aneks – 7.1. sipas kërkesës së Aneks 7 – Kriteret për dhënien e kontratës.

Pretendimet kundër eliminimit të parashtruesit

Pretendimi nr. 1 – *“Andaj ky arsyetim është i pabazuar dhe supozojmë që është bërë nga një komision i njëanshëm, pasi lideri i grupit ka letërpërkrahje nga Pro Credit Bank në vlerë 500,000.00 Euro kurse anëtarë i dytë në vlerë 100,000.00 nga BKT dhe 100,000.00 nga TEB SHA, ndërsa kërkesa e DT ka qenë për 600 mij euro, që ne jo vetëm që e kemi plotësuar por kemi ofruar dëshmi edhe duke e tejkuluar vlerën e kërkuar”*.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 1. Pretendimi ankimor është i bazuar pasi që GOE ka dorëzuar dëshmitë e nevojshme dokumentare për të dëshmuar këtë kërkesë të DT.

Pretendimi nr. 2 – *“Ne kemi prezentuar për inxhinierin e diplomuar të makinerisë z. Remzi Selimi diplomën, kontratën e punës, referencë dhe CV të nënshkruar, certifikat nga IËS, për të cilat edhe ju vetë si AK nuk keni dhënë ndonjë gjetje, përpos certifikatës për ndihmë mjekësore (certifikat të cilën janë obligim të kenë secili vozitës në Kosovë e vende tjera). Ju në rastin konkret me qenë se ne kemi prezentuar këtë inxhinier dhe ka plotësuar kërkesat e DT, lehtësisht keni mundur të zbatoni Neni 72 I LPP-së -Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe ne kemi qenë të gatshëm të ofrojmë këtë certifikat në përputhje me kërkesën e DT dhe me LPP-në, certifikat të cilën po bashkangjesim, e cila certifikat është dokument që ka ekzistuar para skadencës së afatit të dorëzimit të ofertave dhe e lejuar me sqarimet e LPP-së dhe RrPP-së nr.001/2022”*.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 2. Duhet cekur se as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që nuk ka përmbushur këtë kërkesë të DT por vetëm pretendon se AK ka mundur që përmes sqarimeve shtesë t'i mundësoj parashtruesit që të dërgoj dokumentet të cilat mungojnë në ofertën e tij. Pra nuk është kontestues fakti që inxhinieri R.S. nuk i përmban certifikimet e nevojshme. Kërkesa e DT ka qenë *“Inxhinier i diplomuar i makinerisë (min. 3 vjet provojë pune pas diplomimit), të jetë i certifikuar nga një institucion shtetëror ose ndërmarrje publike për ndihmën e parë”*. Parashtruesi nuk e ka dorëzuar certifikatën për ndihmën e parë nga ndonjë institucion shtetëror apo ndërmarrje publike. Duke qenë se nuk ka dorëzuar fare dëshminë e kërkuar dokumentare, është e pamundur që të kërkohej sqarime shtesë për një dokument që nuk është dorëzuar pasi që kjo do të përbënte ndryshim material thelbësor në ofertën e parashtruesit. Nëse do të ishte dorëzuar dokumenti dhe p.sh nëse do të kishte qenë afër skadimit të afatit atëherë AK ka mundur që të kërkohej sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP. Mirëpo në rastin konkret sipas LPP por as sipas RRPP dhe UPP nuk kanë mundur që të kërkohej sqarime shtesë sikurse pretendon parashtruesi. Përtej kësaj nuk është kontestuese gjendja faktike dhe për këto arsye pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 3 – *“Për këtë pozitë ne kemi prezentuar inxhinieri sipas kërkesave në FDT dhe i cili plotëson gjitha pikat dhe ka përvojën e kërkuar mbi 5 vite pas diplomimit (diplomimi 08.02.2017) dhe e ka të evidentuar përvojën në CV e tij. Ju si Autoritet Kontraktuese keni mundur lehtësisht bazuar në nenin 72 të LPP-së të kërkonit sqarime për dokumentacionin e munguar, dhe ne do të mund të prezantonim edhe referencë në përputhje me CV e tij të nënshkruar të cilat mund edhe të ofrohen dëshmi tjera si kontributet pensionale dhe dokumentacion të nevojshëm”*.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 3. Parashtruesi sërish nuk e konteston faktin që nuk ka përmbushur këtë kërkesë të DT por vetëm pretendon se AK ka mundur që përmes sqarimeve shtesë t'i mundësoj parashtruesit që të dërgoj dokumentet të cilat mungojnë në ofertën e tij. Pra nuk është kontestues fakti që parashtruesi nuk e ka dorëzuar CV e nënshkruar, i mungon përvoja e kërkuar si dhe i mungojnë referencat sikurse janë kërkuar me DT. Pra në njërin anë CV e dorëzuar nuk i përmbush kriteret themelore (nuk përcakton vitet e përvojës së punës, nuk është e nënshkruar, etj). Në anën tjetër nuk janë dorëzuar fare referencat sikurse është kërkuar me DT. Sipas pikës 10 të UPP në rastet kur CV nuk përmbushë kriteret nuk ka nevojë që të kërkohen sqarime shtesë. Ngjashëm vlen edhe për referencën e cila nuk është dorëzuar. Duke qenë se nuk ka dorëzuar fare dëshminë e kërkuar dokumentare, është e pamundur që të kërkohen sqarime shtesë për një dokument që nuk është dorëzuar pasi që kjo do të përbënte ndryshim material thelbësor në ofertën e parashtruesit. Nëse do të ishte dorëzuar dokumenti dhe p.sh nëse do të kishte qenë afër skadimit të afatit atëherë AK ka mundur që të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP. Mirëpo në rastin konkret sipas LPP por as sipas RRPP dhe UPP nuk kanë mundur që të kërkohen sqarime shtesë sikurse pretendon parashtruesi. Përtej kësaj nuk është kontestuese gjendja faktike dhe për këto arsye pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 4 - *"Ky arsyetim nuk perkon me rregullat ligjore, përkatësisht ne si OE ne oferte kemi dorezuar kualifikime profesionale ne emer te stafit te mbi kualifikuar. Dispozitat ligjore te LPP-se ne fuqi percaktojne qe AK, ne kerkese aplikon minimumin dhe ofertuesi mund te prezantoj dëshmi te cilat tejkalojne vet kerkesen. Masteri yne për te cilin ju si AK, keni eliminuar ofertën tone edhe pervojen e punes e ka me te larte se sa vlera e percaktuar prej 3 vitesh, rrjedhimisht komisioni vleresues i ofertave do duhej te pershkruante edhe këtë qeshtje si arsyetim te elemimit. Ne për këtë kërkesë të FDT siq edhe keni cekur dhe ju vetë ne kemi prezantuar një master të emergjencave , por arsyetimi i juaj, se ju keni kërkuar bachelor dhe jo master është skajshmërisht diskriminues dhe i padrejtë pasi që ju po hudhni poshtë një person i cili është me mbi kualifikime duke krahasur me kërkesat tuaj dhe i cili plotëson plotësisht këtë kërkesët të FDT-së, për të njëjtin kemi bashkangjitur dëshmi certifikatën për punë ndërtimore e cila është në fushën sigurisë gjatë fazës së projektimit dhe gjatës fazës së realizimit të punimeve, e cila është në bazë të standarteve të sigurisë, sipas rregulloreve per siguri ne kantiere ndertimit dhe sipas standartave ISO të cilat janë standarte ndërkombëtare. Po ashtu duhet të ju informojm që ky ka edhe diplomën teknike Inxhinier i makinerisë i cili drejtim është direkt i lidhur me punë ndërtimore"*

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 4. Parashtruesi nuk e konteston faktin që nuk ka dorëzuar diplomën bachelor por pretendon që diploma e dorëzuar master duhet të trajtohet si ekuivalente. Mirëpo kërkesa e DT është mjaft konkrete dhe përmes saj kërkohet diplomë bachelor dhe jo master. Në shumë raste studimet bachelor mund të jenë në drejtim tjetër dhe master në drejtim krejt tjetër dhe për këtë arsye diploma master dhe bachelor nuk mund të trajtohen si të njëjta. Përveç kësaj, në ofertën e parashtruesit është gjetur se mungon "licenca ose certifikata për punë ndërtimore nga ndonjë institucion shtetëror". Pra,

inxhinieri i prezantuar, nuk plotëson kriterin as për kualifikimin bachelor dhe as për certifikatën ose licencën e kërkuar për punë ndërtimore. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Pretendimi nr. 5 – *“Për këtë pozitë ne kemi prezantuar Master të ndërtimit të drejtimit Gjeoteknik e cila është në përputhje me kërkesen e DT, pasi që në kërkesë ka qenë të prezantohet master shkencave teknike drejtimit gjeoteknike, dhe Master i inxhinierisë së ndërtimit hynë në kuadër të shkencave teknike, po ashtu i njëjti ka drejtimin e gjeoteknikës. Ndërsa sa i përket citimit që në Nostrifikim nuk është përfshirë drejtimi i gjeoteknikës, është arsyetim i pa bazë, për arsye që nostrifikim i dt.26.05.2020 me nr. Ref. 6/4-375 është bërë për diplomën me titull „Magistar inzenjer Gradovinarstoa” me 121.5 ECTS e fituar në „Sveuciliste u Zagrebu” në emër të z. Adrian Kadiri, dhe përfshirja në nostrifikim edhe drejtimi gjeoteknikës nuk është në kompetencën tonë, se me dëshirë nëse do të ishte e lejuar, do të donim të kishin cekur edhe që është bashkpunëtor i Construmax, po nostrifikimet bëhen në bazë të Ligjit”.*

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 5. Parashtruesi ka dorëzuar një vendim për nostrifikim të diplomës sipas të cilit dëshmohet se punonjësi i prezantuar lidhur me këtë kërkesë të DT është inxhinier i ndërtimit dhe jo master i shkencave teknike drejtimit gjeoteknikë (në vendimin për nostrifikim askund nuk potencohet drejtimi gjeoteknikë). Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi nr. 6 – *“Ky arsyetim është i pa bazuar për arsye që punëtorët pas certifikimit për siguri dhe shëndet në punë, kanë kryer edhe trjanimet kualifikimi ashtu siç keni cekur për armiruese latues, moler, zdrukthetë suvatues etj. Gjithashtu ne kemi prezentuar edhe Riskun me të gjitha vendet e punës, duke specifikuar edhe pozitat e cekura nga ana e juaj. Ne për të ju argumentuar që ky arsyetim është i pabazuar, ju sqarojmë që neve si kompani na mbikqyrë dhe inspektoj në vazhdimësi kompania e licencuar HSK shpk për siguri dhe shëndet në punë për të gjitha pozitat dhe të gjitha objektet që jemi duke ndërtuar dhe ato që do të ndërtojmë. Rreth Pretendimit tuaj se ne nuk kemi prezantuar në certifikatat për siguri dhe shëndet në punë profesionin e punëtorit ju përgëzojmë për qasjen e përpikët pasi që në të vërtetë kjo fushë është e rëndësishme së veçantë”.*

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 6. Nëse analizohet me kujdes formulimi i pretendimit ankimor rezulton se as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që mungojnë certifikimet për armirues, latues, zdrukthtar, moler, suvatues, etj. Megjithatë parashtruesi pretendon se ka dorëzuar certifikatat për personat e njëjtë mirëpo të cilët në kohën e certifikimit nuk i kanë pasur këto pozita por kanë qenë vetëm punonjës të thjeshtë dhe më pas përmes kualifikimeve shtesë kanë arritur në pozitat përkatëse. Megjithatë kërkesa e DT ka qenë mjaft konkrete sipas të cilës certifikatat për siguri dhe shëndet në punë duhet të dëshmojnë për pozitat përkatëse dhe jo për pozita të tjera. Argumenti që përdor parashtruesi sipas të cilit vazhdimisht mbikëqyrë nga kompania certifikuese sipas ligjit nuk qëndron pasi që ky argument meqenëse është sipas ligjit duhet të aplikohet njëllëj edhe për kompanitë tjera të kësaj lëmie. Pra nuk është kontestues që parashtruesi nuk ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara dokumentare prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Pretendimi nr. 7 – “Ne kemi prezantuar dy marroeshje për menaxhimin e mbeturinave njëra marrëveshje e Liderit dhe tjetra e anëtarit të konserciumit e cila marrëveshje e antarit është me të njëjtën deponi sikurse marroeshja e GOE të rekomanduar. Pra duke u bazuar në kërkesën tuaj ne kemi prezantuar marrëveshjen nga Lideri me kompani për menaxhimin e mbeturinave . Kurse anëtari i dytë i konserciumit ka paraqitur marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e deponive që ka validitet të mjaftueshëm deri me 03.07.2025, sa është precizuar plani dinamik (planifikimi i punimeve sipas planit dinamik 240 ditë deri me 28.06.2025). Kjo për arsye ne kemi plotësuar kërkesën e FDT-së e cila ka qenë marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave dhe bartjen e tyre dhe po ashtu kemi siguruar pjesën shtesë që nuk ka qenë e kërkuar në dosje të FDT vendin për deponimin e tyre . Kurse GOE i rekomanduar nuk ka prezantuar marrëveshje me kompani për menaxhimin e mbeturinave por vetëm me Deponin e cila nuk ka qenë kërkesë e FDT-së dhe si e tillë nuk do të duhej të pranohej , por po besojmë ju si AK keni vendosur që të kundërshtoni marrëveshjen tonë për të mbrotjur marrëveshjen e gabuar të GOE të rekomanduar. Gjithashtu ju sqarojmë që GOE i rekomanduar për kontrat ka marrëveshje me deponin deri në prill 2024 ndërsa planifikimi i punimeve 220 ditë që i bje deri me qershor 2024, dmth i mungon marrëveshja për 2 muaj (maj, qershor)”.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 7. Parashtruesi ka prezantuar dy marrëveshje një nga lideri dhe një nga anëtari i GOE. Mirëpo sipas DT marrëveshja e prezantuar nga lideri i GOE nuk është për mbeturina inerte pasi që kompania shërbyese nuk posedon fare deponi për mbeturina inerte. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 8 – “Ne kemi rezantuar dy kamionë për këtë pikë të cilët janë në përputhje me kërkesat e FDT-së dhe besoj kanë specifika edhe me të përshtashme se sa kërkesat ne FDT. • Kamioni i parë i prezantuar është: Daimler benz- ATEGO 815 Kamion me kran dhe Kiper me peshë bartëse 1760 kg , kurse pasha totale 5730 kg. • Kamioni i dytë i prezantuar është : MAN L 2000 Kamion me kran dhe kipper dhe peshë bartëse 2130 kg dhe peshë Totale 5360 kg”.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 9. Parashtruesi në pretendimin e tij vet e konfirmon se vetëm njëri nga kamionët e prezantuar është deri në 2 ton ndërsa kamioni tjetër është dukshëm mbi 2 ton. Pra janë kërkuar 2 kamion ndërsa parashtruesi ka prezantuar vetëm 1 i cili i përmbushë kërkesat e DT. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 9 – “Për këtë pikë kemi prezantuar kamionetë IVECO 35C13 DAILY I cili është kamionetë me vinç, sa i përket pikës tuaj se kjo kamionetë i ka 3 ulëse apo 5 ulëse janë jorelevante dhe devijime të vogla, me punimet dhe përdorimin e kamionetës, pasi që kamioneta me vinç përdoret për bartje të materialeve dhe jo personave pasi që nuk kemi të bëjmë me kontratë bartje të personave po kemi të bëjmë me kontratë për punime ndërtimore, për këtë pikë në qoftëse e keni patjetër të nevojshme 5 ulëse ne kemi në dispozicion mbi 7 kamioneta dubelkabinë që do të përdoren gjatë punimeve. Sa i përket peshës bartëse libreza e prezantuar është e lëshuar nga qendrat e regjistrimit dhe si e tillë nuk ka shënime për peshën bartëse , por ne po jua bashkangjesim dëshmi specifikat në bazë të prodhuesi dhe llojit të kamionetës”.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 10. Në dosjen e tenderit është kërkuar kamionetë dubel kabinë me vinç me peshë ngarkuese maksimum 800kg. Në pretendimin ankimor as vet parashtruesi nuk e

konteston faktin se kamioneta nuk i përmbushë karakteristikat themelore të kamionetës dubel kabinë dhe nuk e konteston as faktin që nuk është prezantuar fare pesha ngarkuese e kamionetës. Pra parashtruesi ka dorëzuar një kamionetë jo dubel kabinë. Sa i përket figurave që parashtruesi ka prezantuar në kërkesën për rishqyrtim është gjetur se të njëjtat janë marrë nga burimet e hapura në internet dhe nuk konfirmojnë karakteristikat themelore të pajisjes konkrete për të cilën po bëhet fjalë. Për këtë arsye pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi nr. 10 - *“Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kem prezentuar dudin e noterizuar me nr. R28412 si dhe marroeshjen për shfrytëzim të automjeteve me Alpe shpk. Në dudin doganor R28412 janë të evidentuar $300m^2+425m^2$ dhe në dudin doganor me nr R 6748 janë të evidentuar $75+450m^2$ që në total janë $1250m^2$, dmth tejkalojn sasin e kërkuar në DT. Sa i përket që DUD të prezentuar i mungon pronësia, ju si AK keni mundur të kërkonit sqarime bazuar në nenin 72 të LPP-së”.*

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 11. Parashtruesi nuk e konteston faktin që në DUD mungon pronësia për 500 m² të kallëpit të betonit – dërrasë. Pra edhe mungon sasia edhe pronësia e asaj sasive. Sa i përket marrëveshjes që ka prezantuar parashtruesi me kompaninë ALPE, në këtë marrëveshje askund nuk thuhet që objekt i marrëveshjes është marrja me qira e kallëpeve të betonit – dërrasa. Në fakt objekti i kësaj kontrate nuk specifikohet fare. Si e tillë kjo kontratë nuk mund të merret parasysh pasi që nuk dihet se cilave mjete të punës i dedikohet konkretisht. Për këtë arsye qëndron arsyeja eliminuese ndërsa pretendimi është i pa bazë.

Pretendimi nr. 11 - *“Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kem prezentuar dudin e noterizuar me nr. R6161 si dhe marroeshjen për shfrytëzim të automjeteve me Alpe shpk. Në dudin doganor R6161 është e evidentuar Tualete të përdorura (WC) prej metali për vendpunsishite (Dopio) dy pjesëshë, 1 copë dmth tejkalojn sasin e kërkuar në DT. Sa i përket që DUD të prezentuar i mungon pronësia, ju si AK keni mundur të kërkonit sqarime bazuar në nenin 72 të LPP-së”.*

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 12. Parashtruesi nuk e konteston faktin që në DUD mungon pronësia pajisjen në fjalë. Sa i përket marrëveshjes që ka prezantuar parashtruesi me kompaninë ALPE, në këtë marrëveshje askund nuk thuhet që objekt i marrëveshjes është marrja me qira e kallëpeve të betonit – dërrasa. Në fakt objekti i kësaj kontrate nuk specifikohet fare. Si e tillë kjo kontratë nuk mund të merret parasysh pasi që nuk dihet se cilave mjete të punës i dedikohet konkretisht. Për këtë arsye qëndron arsyeja eliminuese ndërsa pretendimi është i pa bazë.

Pretendimi nr. 12 - *“Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kem prezentuar ne kemi 4 rula sipas kërkesës së FDT-së si dhe kemi prezentuar Marrveshje për shfrytëzim me Mendi SHPK dhe marroeshje për shfrytëzim me Rexha shpk Marrveshje me MENTI SH.P.K. Kemi paraqit tre rula Dudi faqe 1: Rul ËAKER Tipi WH65 peshen e ka 600kg Dudi faqe 2: Rul RDV 50 Tipi Leberto Rul DYNA PAC Tipi 171102KJ/D605, Ku pesha e të dy RULAVE është 1500kg. Marrveshja me REXHA SH.P.K. E kemi faturen e blerjes, duhet me kqyr rufa a e kan fletpagesen”.*

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 13. Fillimisht duhet sqaruar se marrëveshjet për qiramarrje me kompanitë Mendi Shpk dhe Rexha Shpk janë pa objekt të kontratës. Pra aty askund në kontratë nuk thuhet se objekt i qirasë janë rulat hekur me gjemba apo pajisje të tjera specifike. Sa i përket rulave të tjerë që ka prezantuar parashtruesi, asnjëri prej tyre nuk është rul hekur me gjemba dhe po ashtu i mungon dëshmia e pagesës. Në një pjesë të pretendimit ankimor edhe vet parashtruesi e pranon se i mungon fletpagesa ku thotë se *"duhet me kqyr rufa a e kan fletpagesën"*. Po ashtu nuk është dëshmuar në dokumente askund as pesha. Prandaj qëndron arsyeja eliminuese ndërsa pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 13 - *"Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kemi prezentuar ne kemi prezentuar Marrveshje mbi dhënje në shfrytëzim të kamionin me Musa Ibercuk shpk ku kemi prezentuar Librezen për kamionin 04-680-KG si dhe grafitin e kranit HIAB 085D-2 që ka peshën maksimale 4 tonë. Dmth bazuar në dokumentacionin e prezentuar ne kemi prezentuar dokumentacion të mjaftueshëm për këtë kërres dhe kamioni është kiper dhe ka kran që ka peshë bartëse maksimumi 4 ton në përptuhje me kërkesat e DT"*.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 14. Fillimisht duhet sqaruar se marrëveshja për qiramarrje me Musa Ibercuk është pa objekt të kontratës. Pra aty askund në kontratë nuk thuhet se objekt i qirasë është kamioni kiper me kran me peshë nga 3 deri në 4 ton. Përndryshe edhe pajisja që e ka prezantuar parashtruesi si e tillë është 7555 kg me peshë bartëse 7445. Pra nga secili këndvështrim i mundshëm, arsyeja eliminuese qëndron ndërsa pretendimi është i pabazuar në tërësi.

Pretendimi nr. 14 - *"Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kemi prezentuar dudin doganor me nr R 1130 i dt 11.03.2019 në emër të NPT Dita dhe të evidentuar Eskvator i përdorur Mara Maxima, Tipi: TB108 ngjyra e kuqe viti i prodhimit 1989 pesha Bruto dhe Neto 800kg, si dhe kemi bashkangjitur Faturen e Blerjes nga Gezim Kolgeci nga NTP DITA. Po ashtu kemi bashkangjitur edhe kontrat mbi dhënjen në shfrytëzim (qera) të mjeteve themelore të punës për këtë projekt"*.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 15. Pretendimi ankimor është i bazuar pasi që parashtruesi ka dorëzuar fletëpagesën.

Pretendimi nr. 15 - *"Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që nuk ka qenë e precizuar që Traktori të këtë librezë regjistrimi, gjithashtu secila makineri punuese që është i nevojshëm për punishte - mirëmbajtje të rrugëve duhet të kenë regjistrim duke përfshir edhe eskvatorat, kompresorat, gjeneratorat etj etj, mirpo në rastin e këtij projekti kemi të bëjmë me një kantier ndërtimit, që nuk ka nevoj traktori të lëviz në komunikacion, mirpo është i nevojshëm për punime mbrenda kantierit. Ne kemi prezentuar Marrveshje shfrytëzimi me Seti Comerc, kemi prezentuar Dudin doganor të Traktortit sipas kërkesave të DT. Sa i përket arsyeve eliminuese arsye që nuk kemi prezentuar librezë të regjistrimit për traktorin, për të cilat sipas ligjit për automjete Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, nuk është obligim paisjet të cilat përdoren në kantier të regjistruhen, dhe nuk ka qenë e përcaktuar në DT që të prezantohet librezë për traktor"*.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 16. Fillimisht duhet sqaruar se pajisja "traktor 4x4 me lugë ngarkuese" është në mesin e pajisjeve që duhet të regjistrohet dhe ky fakt nuk duhet të ishte aspak kontestues. Të gjithë traktorët regjistrohen dhe pronari apo poseduesi nuk vendos se cilat pajisje janë të dedikuara për vendpunishte dhe cilat për komunikacion por vendosin politikat ligjore në fuqi për regjistrimin e pajisjeve në Republikën e Kosovës. Përndryshe të gjithë traktorët duhet të regjistrohen. Në anën tjetër parashtruesi nuk e konteston faktin që nuk e ka dorëzuar librezën e qarkullimit për këtë pajisje dhe ky fakt nuk është fare kontestues. Për më tepër as nuk konfirmon nëse ka regjistrim në pretendimin ankimor. Prandaj qëndron arsyeja eliminuese dhe pretendimi si i tillë është i pabazuar në tërësi.

Prendimi nr. 16 - "Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kemi prezentuar dudin e noterizuar me nr. R6748 (dt.26.03.2016), R 43199 (dt. 24.12.2019) si dhe marrvëshjen për shfrytëzim të automjeteve me Alpe shpk/ Në dudin doganor R6748 është e evidentuar skele lëvizëse e përdorur me rrota prej alumini si dhe në dudin R43199 në artikullin e dytë ka Skele të përdorura lëvizëse me rrota, prej alumini po ashtu në artikullin 4 ka pasije për skela, veshje me dërrasa, për mbështetjet dhe mbështetje - pajisje skelerie të përdorura për punë ndertimore, shtylla 590 cp, aksesore montuese për skele 7 depozita dmth.vetëm mbrenda dudit R43199 janë 590 copë shtylla të skeleve dhe 7 aksesore montuese (depozita) që jo vetëm kanë sipërfaqen 200m² po e tejkalojnë Në çdo 2.4m' vendoset një shtyllë dhe lartësia 2m' 590x2.4x2=3186m². Gjithashtu edhe dudi me nr R6748 i cili ka qenë i prezentuar ka me mijra metra katror që janë të leviezshme. Gjithashtu ne kemi prezentuar edhe faturën 11363 që ka të evidentuar rrota skele 4 copë, si dhe kemi edhe shumë skele në dispozicion, në rast nevojë mund të ju ofrojmë dëshmi shtesë".

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 17. këtë marrëveshje askund nuk thuhet që objekt i marrëveshjes është marrja me qira e skelebe 200m². Në fakt objekti i kësaj kontrate nuk specifikohet fare. Si e tillë kjo kontratë nuk mund të merret parasysh pasi që nuk dihet se cilave mjete të punës i dedikohet konkretisht. Parashtruesi ka dorëzuar DUD doganor por me të cilin nuk përmbushen as për së afërmi 200m² skele sikurse është kërkuar me DT. Për këtë arsye qëndron arsyeja eliminuese ndërsa pretendimi është i pa bazë.

Prendimi nr. 17 - "Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kemi prezentuar listën e paisjeve Aneksin -8 ku kemi të evidentuar 1.7 pompë suvatimi 3 copë, ku kemi prezentuar dudin e noterizuar me nr. R22493 (dt.07.08.2017), marrvëshjen për shfrytëzim të automjeteve me Alpe shpk, si dhe kemi edhe fatur blerje Construmax (fatura no.99 dt.07.11.2022 e paguar me 21.11.2022 e cila ka qene ne dokumentacion folderi 16 paisjet fjali 1.18) dhe fatur blerje Harst Group (fatura nr. 61/20 dt.17.12.2020 e paguar me 17.12.2020) Në dudin doganor R22493 është e evidentuar Makine e përdorur për lyerje me llaq G-4, në faturën e Construmax është evidentuar pomp suvatimi, në faturën e Harst Group është evidentuar Maqin Suvatimi G4, dmth ne kemi 3 pompa suvatimi që tejkalojnë kërkesat minimale të DT. Sa i përket që DUD të prezentuar i mungon pronësia, ju si AK keni mundur të kërkonit sqarime bazuar në nenin 72 të LPP-së"

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 18. Nga dokumentet që janë dorëzuar me ofertë nga parashtruesi, është gjetur se mungon

një njësi e pajisjes por edhe te pajisjet tjera mungon dëshmia e pronësisë. Prandaj arsyeja eliminuese qëndron ndërsa pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 18 – “Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kemi prezentuar listën e paisjeve Aneksin -8 ku kemi evidnetuar që posedojmë rreth 6500m² që tejkalojn kërkesat e DT. Gjithashtu ne kemi ofruar dëshmi marroeshjen për shfrytëzim me Alpe shpk, si dhe kemi prezentuar disa nga dudet që kanë qenë kërkesa si për skele lëvizëse 200m² ne kemi prezentuar vetëm bazuar në atë dudë nr. R6748 (dt.26.03.2016) janë mbi 3186m², R 43199 (dt. 24.12.2019) janë 3790copë , që bëjnë 6976m² kur të zbrisim 200 m² kërkeës për skele lëvizëse mbesin 6590m². Sa potencimit që kemi paraqitur skele te hekurit me kg ne asnjë menyre nuk i mberrijn ato metra katror, mendojmë që është supozim jo real, dhe në momentin që nuk ken ditur të kalkuloni, keni mundur të kërkonit sqarime bazuar në nenin 72 të LPP-së”.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 19. Sa i përket marrëveshjes për qira me kompaninë ALPE shpk, përshtatshmërisht vlejné elaborimet e prezantuar lidhur me pretendimet tjera ankimore në këtë vendim. Sa i përket skeleve për punë ndërtimore 5000 m², as vet parashtruesi nuk e konteston që ka prezantuar skele të hekurit me kg të cilave nuk ju shënon askund metërgjatësia. Kalkulimi i prezantuar nga parashtruesi është interpretim subjektiv i cili askund nuk evidentohet në dokumentet e dorëzuara me ofertë. Prandaj arsyeja eliminuese qëndron ndërsa pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 19 – “Ky arsyetim është i pa bazuar për faktin që ne kemi plotësuar formularin e tenderit përkatësisht aneksin -7.1 ashtu siç ka qenë formulari në DT, dhe nuk kemi ndërhyr në formular tenderi ashtu siç ka vepruar GOE i rekomanduar për kontrat. Dmth ju na keni eliminuar me arsyetim të pa bazë, për arsye që jeni bazuar në formular të GOE të rekomanduar për kontrat, pa e kontrolluar në DT se si ka qenë e publikuar. Andaj në rastin konkret GOE i rekomanduar për kontrat ka ndryshuar formularin standart të Aneksi – 7.1 dmth ka vendosur edhe një një klauzol shtesë e cila nuk ka qenë në formularin standart të tenderit, dhe në rastin konkret ju si AK do të duhej të eliminonit GOE të rekomanduar për kontrat për arsye të ndërhyrjeve në formularin standart Aneks 7.1 dhe kushtëzimin e tij me preambulën II duke evidentuar që garancioni 5 vite nga data e pranimit të përkohshëm, ndërsa në DT nuk ka qenë e precizuar garancioni a vlenë pas pranimit të përkohshëm apo pas pranimit final”.

- **Përgjigja:** Përmes këtij pretendimi parashtruesi e konteston arsyen eliminuese nr. 20. Ky pretendim është pjesërisht i bazuar pasi që parashtruesi e ka plotësuar formularin ashtu sikurse është bashkangjitur me DT të korrigjuar (ku ka munguar periudha) garantuese dhe jo në dosjen fillestare të tenderit, pavarësisht faktit që në të dy DT në ankes 7 ka pasur instruksione mjaftueshëm të kuptueshme se në ankes 7.1 duhet të plotësohet edhe periudha garantuese. Sidoqoftë pretendimi ankimor është i bazuar pjesërisht.

Pretendimet kundër tenderuesit të rekomanduar

Pretendimi nr. 20 – “Ky GOE ka ndërhyr në formularin standart të DT përkatësisht në Aneksin 7.1 duke shtuar një preambul kushtëzuese për Autoritetin Kontrkatues, i cili text nuk ka qenë në formularin standart të DT. Duke u bazuar në Rregulloren Për Prokurim Publik

Faqe 11 nga 16

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

nr.001/2022, përkatësisht nenin 44 Formularët Standart pargarafi 44.3 citon „Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde.”, ku në rastin konkret GOE Limit Projekt ka ndërhyr në këtë formular duke vendosur preambul shtesë. Andaj konsiderojmë që ky GOE duhej të eliminohet si administrativisht i papërgjegjshëm”.

- **Përgjigja:** Tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka plotësuar aneksin 7.1. të dosjes fillestare. Përndryshe në aneks 7 ka pasur instruksione konkrete sipas të cilave duhet të plotësohet aneks 7.1 edhe sa i përket periudhës garantuese. Prandaj tenderuesi i rekomanduar ka plotësuar aneks 7.1 në mënyrë të rregullt.

Pretendimi nr. 21 – “Nuk janë korrigjuar gabimet tek Punët Gypor i ngrohjes/Ftohjes në pozicionin 2.19, do të duhet të jetë 70% nga vlera e pozicioneve 16-17, ndërsa GOE ka vendosur qmim jo në përputhje me përshkrimin e këtij pozicioni. Po ashtu ka gabim në qmim edhe për pozicionin tek Punimet e Vetilimit të Bodrumit pozicioni 5.6 do të duhej të vendosje shuma e pozicionit 1, mirpo GOE ka vendosur qmim tjetër jo në përputhje e përshkrimin e pozicionit”.

- **Përgjigja:** Sipas nenit 59 par. 3 të LPP lidhur me nenin 40.9 të RRPP “Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total”. Në rastin konkret ekzistojnë gabime aritmetikore mirëpo të cilat nuk tejkalojnë mbi vlerën 2%. Vlen të thuhet se gabimet aritmetikore nuk llogariten brenda kategorisë (pozicioneve) por llogariten në pozicionet e përgjithshme. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 22 – “Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk kanë paraqit fare deklaratat për krijimin e grupit në a, b, c, - Nuk kanë paraqit marrveshje të konzerciumit, pasi që në dy qasje të lejuar nuk na është ofruar këto deklaratat, po ashtu nuk e ka të evidentuar as në formular të dorëzimit të tenderit të Lista e dokumenteve të tenderit mbështetës”.

- **Përgjigja:** Pretendimi është i pabazuar pasi që dokumentacioni i pretenduar nga parashtruesi gjendet në follderin 16.1. të tenderuesit të rekomanduar dhe së bashku me të janë të bashkangjitur deklaratat sipas marrëveshjes së konzerciumit.

Pretendimi nr. 23 – “Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk kanë paraqit fare plan dinamik, edhe pse në list të dokumenteve të tenderit mbështetës në nr. 22 ka të evidentuar plani dinamik, mirpo në qasje nuk na është prezentuar, pasi që plani dinamik nuk mund të konsiderohet edhe sekret afarist”.

- **Përgjigja:** Mbështetur në piken 19.1(h) kompania ka deklaruar se do t’i realizoi punët brenda afatit 120 deri në 240 ditë. Përndryshe tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar planin dinamik përmes folderit 12 të ofertës së prezantuar. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 24 – “Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se vlerësimin e rrishtit e ka të prezentuar të pjesëshëm, dmth nuk e ka vlerësimin e rrishtit për gjitha vendet e punës, pasi që rrishtit duhet të behet për komplet vendet e punës, kompania ose ka fshehur të gjitha pozitat e punës dhe rrishtit është i pjesëshëm. dmth në rrishtit nuk janë të perfshir të gjith inxhinieret, e as tekniket e as puntoret e trjanuar. Bazuar në ligjin 04 L-161 kompanit duhet të ketë rrishtit për të gjitha vendet e punës”.

- **Përgjigja:** Kompania e rekomanduar për kontratë ka paraqitur raport të vlerësimit ashtu siç është kërkuar me DT. Në fakt raporti i rrishtit është prezentuar për të gjithë anëtarët GOE pikërisht sipas DT. Ky raport ndodhet në folderin 11 të ofertës. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Pretendimi nr. 25 – “GOE Limit Projekt – Nuk ka të prezentuar certifikata për punëtor që janë trjanuar në shëndet në punë Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk ka plotësuar kërkesat dhe dëshmit e kërkuar që punëtoërt duhet të jenë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, mirpo ka të prezentuar vetëm certifikata për siguri në punë, nuk i ka të trajnuar edhe për shëndet në punë”.

- **Përgjigja:** Tenderuesi i rekomanduar ka paraqitur certifikata të mjaftueshme sipas kërkesës DT. Andaj pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 26 – “GOE Limit Projekt – nuk plotëson 60% e punëtorëve të trjanuar Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk ka përmbushur kërkesën 13 për arsye që në kërkes ka qenë e parapar që udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të punëtorëve të kërkuara më lartë, ku në mesin e punëtorëve kanë qenë të kërkuara një armirues, një latues - zdrukthëtar, dy molerë, një suvatues, ndërsa udhëheqësi i grupit plotëson vetëm 20% të kësaj kërkesë, pasi që : Armiruesi z. Alban Hylenaj I punësuar në Rinesa shpk Latuesi z. Bahri Olluri I punësuar në Limit Projekt shpk Zdrukthëtar z. Mustafë Topalli I punësuar në Delta CCD shpk Moleri z. Yll Ramadani i punësuar në Rinesa shpk- në kontrat e ka të shënuar murator Moleri z. Arian Ramadani i punësuar në Rinesa shpk Suvatuesi z. Hysni Deliu i punësuar në Limit Projekt DMTH Lideri Limit Projekt ka përmbushur vetëm 20% të kërkesës, nuk ka përmbushur kërkesën prej 60% siq ka qenë kërkesa në DT, si si i tillë do të duhej të refuzohej tenderi”.

- **Përgjigja:** Tenderuesi i rekomanduar ka paraqitur certifikata të mjaftueshme sipas kërkesës së DT. Andaj pretendimi është i pabazuar. Kërkesa e DT është “Pika 13. (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt - minimumi 25 punonjës, min. 20 prej tyre të jenë të certifikuar për Siguri dhe Shëndet në punë. 5 punëtorë tjerë, të jenë të trajnuar për profile të ndryshme në fushën e ndërtimit, si p.sh një armirues, një latues - zdrukthëtar, dy molerë, një suvatues Certifikimi duhet të ndonjë kompani e akredituar dhe aktive Shënim Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të punëtorëve të kërkuara më lartë”. Pra, nuk është kërkuar që këta 5 punëtor (60% e tyre të jenë të liderit të GOE) por 60% e 25 punëtorëve. Në rastin konkret kërkesa e DT është përmbushur pasi që lideri i GOE ka paraqitur +15 të punësuar të cilët janë të certifikuar.

Pretendimi nr. 27 – “GOE Limit Projekt – nuk plotëson 60% e referencave për renovime dhe ndërtim të lartë. Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk përmbush kërkesën e liderit prej 60% të referencave për renovime ose ndërtim të lartë mbrenda 3 viteve të fundit, po ashtu edhe si grup nuk plotësojnë kërkesën prej 3,500,000.00€ dhe nuk kanë arritur të

prezentojn referenca që kanë kryer punime mbrenda 3 vite për renovim dhe ndërtim të larta. Shumica e referencave dhe procesverbalet janë për punime të rrugëve, kanaleve dhe punime të ndërtimit të ulët. Andaj konsiderojmë që ky GOE nuk ka përmbushur kërkesën për të dëshmuar dëshmi që ka kryer punime mbrenda 3 viteve, edhe pse ka prezentu disa referenca gjatë 3 viteve të fundit, mirpo ato kontrata kan filluar shumë kohë para 3 viteve të fundit”.

- **Përgjigja:** Tenderuesi i rekomanduar e përmbushë kërkesën e DT dhe lideri i GOE ka mbi 2.1 milion euro kontrata me pranime teknike ose referenca për punë të natyrës së ngjashme sipas kërkesës së DT. Sipas kërkesës së DT nuk është relevante koha kur ka filluar zbatimi i kontratës por relevante është vetëm nëse kontrata ka përfunduar në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë. Lidhur me këtë fakt ekzistojnë edhe disa interpretime nga KRPP.

Pretendimi nr. 28 – “GOE Limit Projekt – Në kundërshtim me nenin 72 janë kërkuar sqarimet për Bahri Ollurin- është bërë vazhdimi i validitetit të certifikate në formë reteroaktive. Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk ka prezentuar certifikat valide për specialistin për punimin e drurit dhe ju si AK në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së keni kërkuar të vazhdohet rinovimi i certifikatës të këtij tekniki ngase i ka kaluar afati. Dmth ky dokument ka qenë pa validitet dhe vazhdimi i validiteti në mënyr retroaktive nuk mund të konsiderohet i mirqenë sipas LPP-së”.

- **Përgjigja:** Tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar dy persona me kualifikime të njëjta për këtë pozitë edhe pse sipas dosjes është kërkuar “një latues – zdrukthëtar qe nenkupton nje person”. Sqarimet janë kërkuar në përputhje të plotë me nenin 72 të LPP. Pretendimi është i pabazuar.

Pretendimi nr. 29 – “GOE Limit Projekt – Marrveshja për mebturina nuk ka validitet kohor aq sa është planifikuar nga GOE Konsiderojmë që ky GOE kan i rekomanduar për kontrat ka marrveshje me deponin deri në prill 2024 ndërsa planifikimi i punimeve 220 ditë që i bje deri me qershor 2024, dmth i mungon marrveshja për 2 muaj (maj, qershor). Dmth ka një marrveshje për peridhu fikse deri me 10.04.2025 dhe pa ndonjë nenë që mund të vazhdohet. Andaj konsiderojmë që marrveshja e prezentuar nuk ka validitet për kryerjen e këtij projekti, dhe si i tillë do të duhej refuzuar oferta e këtij GEO”.

- **Përgjigja:** Kërkesa e DT është si vijon “14.Marrveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave e nënshkruar nga të dy palët – hudhjen e materialeve të demoluara (inerte).14.Marrveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave e nënshkruar nga të dy palët (origjinal). Marrveshja duhet të jetë para datës së njoftimit (Lideri)”. Askund nuk është kërkuar validitet apo kohëzgjatje në DT. Rrjedhimisht tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur kërkesën e DT ashtu sikurse ajo ka qenë e formuluar në FDT. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi nr. 30 – “Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që kontratat për kërkesën 3 ixhinierin e diplomuar të dërtimtarisë bien ndesh me përshkrimin e sajë, dmth në kontrat është e parparap për kohë të pacaktuara ndërsa në përshkrimin e saj ka parapar një periudhë prej 1 vjeqare. Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që kontratat për kërkesën 5 për inxhinierin e makineris si dhe për kërkesën 10 për masterin e

shkencave teknike është prezentuar kontrat pune të pa caktuar, dmth nuk dihet për qka është kjo kontrat”.

- **Përgjigja:** Parashtruesi nuk e konteston faktin se kontratat e punës janë bashkangjitur me ofertë dhe se të njëjtat janë valide. Në anën tjetër kontratat si të tilla janë tërësisht të vlefshme për të përmbushur kërkesat përkatëse të DT. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se forma e kontratës ka mundur të jetë më ndryshe, ky aspekt për aq sa është argumentuar nga parashtruesi nuk është relevant për vlerësimin e kontratave në raport me DT. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi nr. 31 – “Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që në Dosje të tenderit ka qenë e precizuar që afati për fillimin dhe përfundimin e punimeve të jetë 240 ditë, ndërsa ky grup ka dhënë deklarat që do të përfundoj 220 ditë, që është në kundërshtim me kërkesat e DT”.

- **Përgjigja:** Afati i implementimit është brenda margjinave të kërkuara në DT prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi nr. 32 – “Konsiderojmë që ky GOE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk ka dorëzuar deklarat e ATK-së për 3 vitet e fundit, dhe dyshojmë që nuk ka qarkullimin e kërkuar”.

- **Përgjigja:** Tenderuesi i rekomanduar përmes folderit 4 në ofertë i ka dorëzuar deklaratat në ATK për 3 vitet e fundit përmes të cilave ka dëshmuar qarkullimin e mjaftueshëm sikurse është kërkuar me DT. Pretendimi është i pabazuar.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara. Sa i përket disa prej pretendimeve ankimore të cilat janë gjetur si të bazuara pjesërisht apo tërësisht, të njëjtat nuk mund të manifestojnë asnjë ndikim në epilogun përfundimtar të këtij vendimi dhe nuk përbëjnë argumente ligjore të mjaftueshme për të kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.11.2024

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.